

HATIXHE KONOMI



Datëlindja: 03.02.1978

Vendlindja: Berat

Email: hatixhe.konomi@parlament.al

Jetëshkrimi:

Ka lindur në Berat, më 3 shkurt të 1978. Hatixhe Konomi ka kryer studimet universitare në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja, Dega Frëngjisht, Universiteti i Tiranës në vitin 2000, si dhe Master Menaxhim Ndërkombëtar në “Horizons University”, Paris në 2010. Znj.Konomi në 2011 ka kryer studimet Post-Master në shkenca Administrative në “Albania University”, Tiranë.

Ajo ka një eksperiencë të gjatë në punë si Specialiste të Dhënash, Konsulente Kordinatore në disa projekte të financuar nga CEB (Këshilli i Bankës së Europës), USAID etj. Gjithashtu Znj.Konomi ka eksperiencë edhe në fushën e mësimdhënies pasi ka punuar si: Kordinatore Departamenti dhe Lektore e Gjuhës Frënge pranë “Albania University”, ka mbajtur pozicionin e Zv.Kryetares në Bashkinë Berat. Ajo ka marrë pjesë aktive në disa trajnime dhe projekte si: për Udhërfyesit Turistikë Lokal, Shoqata Kombëtare e Udhërfyesve Turistikë Shqiptar NATGA, Trajnim në përgatitjen e projekteve, në kuadër të programit të zhvillimit të projekteve rajonal si dhe trajnuar për menaxhimin e integruar të siteve të trashëgimisë botërore.